



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06 - 12434 2023

Klinë, Datë: 07.04.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 28. 02. 2023, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në mbledhje: Anëtaret e Kuvendit të Komunës, kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, nënkyryetarja e Komunës, drejtorët e Drejtive, përfaqësues të policisë së Kosovës, përfaqësues të OSBE, Mediat lokale si dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë. Kryesuesi konstatoi se prezent në mbledhje janë 25 anëtarë të Kuvendit. Kushtrim Haliti është duke mbërri së shpejti dhe se Kuvendi mund të vazhdoj me punimet.

Kryesuesi theksoi se në lidhje me furnizimin e anëtarëve të kuvendit me llaptop, kanë mbërri por janë kthyer mbrapsht pasi që nuk i kanë plotësuar kriteret e porositura. Tani pritet mbërritja e tyre ashtu siç janë porositur. Po ashtu kryesuesi i Kuvendit kërkon që të bëjnë deklarimin e pasurisë sipas ligjit dhe afateve të caktuara. Ndërsa për drejtorët kishte porosi që të marrin pjesë në ftesat që ju bëhen për mbledhje nga Komitetet e formuara nga ky kuvend.

Hapet Debat për Rendin e Ditës, prezent janë 26 anëtarë.

Rendi i Ditës u MIRATUA me 26 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstinenim.

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave.

Prezent në mbledhje janë 26 anëtarë të Kuvendit, pritet që të bashkëngjitet edhe Kushtrim Haliti.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje për të gjithë. Unë isha ndalë pak tek procesverbal tek pika e 6 e Rendit të ditës së mbledhjes së kaluar, e kam lexuar dhe shikuar në video. Dua të sqaroj diçka në lidhje me diskutimin tim. Në këtë pikë unë kam diskutuar dhe është shkruar nga procesmbajtësi diskutimi im. Po e lexoj sepse e diji pjesën e përgjigjes që keni dhënë ju dhe këtu te kjo besoj nuk është krejt në rregull.

z. Gashi e lexon pjesën e vet të diskutimit dhe ndalet përsëri tek diskutimi i tij në lidhje me drejtorinë e shëndetësisë. Zafer Gashi ka vërejtje tek fjala e kryesuesit, z. Fadil Gashi dhe insiston debatin rreth diskutimit të kryesuesit gjë që bënë të reagoj kryesuesi i kuvendit z. Fadil Gashi i cili ja bënë me dije se Zaferi ka të drejt të flas dhe bëjë vërejtje vetëm për fjalën e tij nëse ajo nuk ju ka shkruar qysh ka folur por jo për fjalimet e të tjera. Reagimin dhe kundërshtimin do të duhej ta bënte në mbledhjen e kaluar dhe kërkon nga procesverbal që të mos i evidentoj këto debate jo relevante.

Me 25 vota për, 2 kundër (LVV), abstenim asnjë MIRATOHET

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së.

Kryesuesi thekson se të gjitha rekomandimet janë në rend të ditës përvèç dy kërkeseve. Një nga OVL e UÇK-së e cila ka kërkuar një hapësirë për vendosjen e shkronjave UÇK , hapësirë që nuk është pronë e komunës dhe kërkesa e dytë e një zonje që kërkon ndihmë për çështje banimi. Ka kërkuar ndihmë mujore prej 250 euro për qira të banimit.

z. Esat Raci: Përshëndetje të gjithëve. Unë dëshiroj që të ju pyes ju se çfarë po bëhet me anëtarin tonë në KPF? Ndërsa sa i përket rekomandimeve unë propozoj si zakonisht të kalojnë në pako.

z. Fadil Gashi, kryesues: Jemi në pritje të konfirmimit nga ministria për ligjshmëri prandaj nuk kemi pasur mundësi që të i ftojmë anëtarët e rijinë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Përshëndetje. Sigurisht nëse votohet nga Kuvendi kërkesa e zonjës për ndihmë ne do të jemi në gjendje që ta realizojmë vendimin e Kuvendit.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje. Ne jemi dakord që të votohen në pako rekomandimet pasi që të gjitha janë në rend dite përvèç kërkësës së fundit që është ajo e subvencionimit të qirasë. Ashtu siç e tha edhe kryetari për kërkësën për ndihmë që ekziston mundësia por të shikohet mundësia për hera të tjera që kjo çështje të rregullohet në bazë të vendimit administrativ 19/2010 që i parashev bonuset sociale sepse ne mund të kemi vazhdimisht kërkesa të tillë. Në lidhje me kërkësën , ne pajtohem me shumën që është paraparë.

Kryesuesi kërkoj që kjo të shqyrtohet tek zyra e kryetarit. Kjo u vendos në votim dhe me 27 vota për u Miratua kërkesa në fjalë.

Rekomandimet e tjera në pako me 27 vota për,asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUAN.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Ekzekutivit për vitin 2022

z. Zenun Elezaj, kryetar: Bazuar në planin e punës së ekzekutivit të miratuar në kuvend për vitin 2022. Çdo periudhë 3 mujore është raportuar në kuvend për punën, sfidat, vështirësitë e përcjellura . këto raporte tre mujore janë inkorporuar edhe në këtë raport vjetor. Besoj që është prezantuar çdo gjë reale por normal ka vend për përmirësimet dhe ne jemi duke u shërbyer çdo vit me përvaja të reja me qellim të përmirësimit. Jemi të hapur për debat.

Znj. Besiana Gashi: Përshëndetje. Në këtë raport kam vërejt që drejtoria e shërbimeve publike gjatë vitit 2022 ka investuar në shumë fshatra në ndriçimin publik por që do të duhej edhe në fshatin Çabiq që është edhe vendlindja e heroit Mujë Krasniqi.

z. Esat Raci: Përshëndetje të gjithëve. Thënë të drejtën nëse më pyesni a e ke lexuar këtë raport, ju them që jo sepse ka qenë shumë voluminoz e besoj që as kryetari dhe të tjerët nuk e kanë lexuar sepse është një raport prej më shumëse 100 faqesh. Premtimet e kryetarit nuk janë realizuar. Me keqardhje grupi ynë nuk do ta votoj këtë raport pune. Pse nuk do ta votoj? Sepse në këtë raport nuk lexova për punën më të madhe që ka bërë ky ekzekutiv. Askund nuk është përmendur puna më e madhe e bërë- Punësimet politike. E them këtë sepse kemi materiale të bollshme që konkurret janë përshtat me qellim të punësimit të militantëve të partisë në pushtet. Pra janë punësimet politike dhe mos përbushja e premtiveve të dhëna nga ana e kryetarit. Punësimet politike e them dhe dua të ndalem në disa raste.

z. Raci theksoi në vazhdim se janë bërë përpjekje për punësimin e S.M. por që në dy raste kanë dështuar. Ai përmendi një vendim të këshillit të pavarur mbikëqyrës i cili ka kërkuar riorganizimin e konkursit si dhe e ka cilësuar komisionin e pranimit si të jashtëligjshëm sipas zotit Raci. "Janë afërsisht 20 punëtorë të pranuar nga ky komision i jashtëligjshëm ku 90% përafërsisht janë militantë dhe aktivistë të AAK-së..." theksoi mes tjerash Esat Raci. Ai përmendi edhe një rast tjetër të një konkursi për bibliotekë pa planifikuar buxhetin dhe duke qenë akoma në punë zyrtarja në Drenoc. Njëjtë sipas zotit Raci ka ndodhë edhe me zgjedhjen e drejtoreve nëpër institucionet arsimore. Ndërsa në disa raste u ndal tek premtimet e kryetarit Elezaj gjatë fushatës së fundit zgjedhore dhe që sipas zotit Raci nuk janë mbajtur ato premtive. Këto dhe shumë të tjera janë arsyet që ne nuk do ta votojmë këtë raport.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje të gjithëve. Duke e shikuar raportin e punës së ekzekutivit për vitin 2022 nuk mund të gjesh ndonjë projekt serioz që ka përfunduar gjatë vitit që kaloi. Qysh e tha edhe parafolësi ka dhe është ushtruar ndikim shumë i madh në procesin e punësimeve në administratë dhe në arsim. Po dihet paraprakisht se kush do të punësohet kështu që konkurrenca po eliminohen në start. Nepotizmi vërehet në çdo segment të qeverisjes dhe nuk besoj që është më e theksuar diku tjetër se sa

tek ne në Klinë. Numri i mësimdhënësve në raport me nxënësit duke e ditur rënien e numrit të nxënësve, janë 85 mësimdhënës më shumë në procesin mësimorë se sa që do të duhej e kjo d.m.th. se kemi të bëjmë me një menaxhim jo të mirë.

z. Limanaj shprehu shqetësimë të tjera si ajo e furnizimit me lëndë djegëse në shkolla që është bërë me vonesë si dhe shqetësuese është kur drejtoret kërkijnë furnitor përlëndë djegëse. Ka neglizhencë të theksuar brenda kësaj drejtorie. Drejtoria e arsimit anulon ditët e shkollave duke shkelur udhëzimet administrative. “ Në këtë sektor ndoshta do të duhej të përzgjidhet menaxheri më i mirë nga të gjitha sektorët e tjerë e jo të kemi gjithë këto telashe” – theksoi z. Limanaj në fund të fjalës së tij.

z. Zafer Gashi: Si lëvizje vetëvendosje gjatë kësaj kohe jemi munduar që të kontribuojmë me debate e kërkesa që kanë qenë në interes të qytetarëve. Vetëm përqindje e vogël nga ju kanë pasur mirëkuptim. Një e mirë e madhe është se u bashkuam në një moment dhe e ndalem një të keqe të madhe , atë të ndërtimit ét fabrikës së çimentos. Do të ndalem në disa drejtori që përmendimin tim ka pasur dështime të mëdha. Te drejtoria e arsimit, mendoj që një problematikë që e kemi ngritur për shkollën e mesme “Fehmi Agani”, drejtimi mjekësi, kemi gjetur shkelje dhe inspektorati ka vendosë që ta ndërpres keqpërdorimin dhe ka urdhëruar drejtorinë që të organizoj konkurs të ri për pranimin e kuadrit.

z. Gashi vazhdoj akoma më tej në lidhje me këtë problematikë të theksuar në drejtimin Mjekësi në shkollën e mesme profesionale. Pas kësaj vuri theksin tek investimet kapitale dhe vuri në dukje ujin e pijshëm. “ Ndërtimi i stacionit të autobusëve ka përfunduar në vitin 2021, kështu thekson në raportin e vitit 2021 ndërsa të njëjtin e kemi edhe tash në raport të 2022. Përveç kësaj a ka pasur sukses ndërtimi i liqenit akumulues? Ka shumë projekte nga drejtoria e urbanizmit që është dashtë të menaxhohen më mirë dhe të ketë më shumë kualitet në punime. E fundit që është edhe më e rendë , kemi pasur falsifikime të dokumenteve zyrtare nga vet komuna. Fjala është për zgjedhjen e drejtorit të QKMF-së, rasti i kontratës së punëtoreve në shkollën e mesme “Fehmi Agani” kur ja bënë kontratën Master ndërsa zonja është Bachellor. Kemi rastin kur refuzohet dhënia e hapësirës përvendosjen e reklamës së biznesit- shkelje e rregullores e cila askund nuk e ndalon vendosjen e reklamës së biznesit. Uroj që kjo qeverisje të mos veproj ashtu siç ka vepruar në vitin 2022. E kemi ngritur zërin vazhdimisht që të kontribuojmë në të mirë të qytetarëve dhe asnjë personale”- theksoi z. Gashi në fund të fjalimit të tij.

z. Valmir Bacaj: Që të jap një vlerësim real të raportit ne do të kthehem i mbrapa dhe bëjmë një krahasim të planit të punës së miratuar dhe realizimin e tij. Pra nëse bëjmë një krahasim atëherë mund të themi se kemi një realizim të synimeve dhe objektivave të planifikuar. Ky është një raport vjetor i punës dhe nuk është një raport i premtiveve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore sepse kemi edhe tre vite kohë. Ju propozojmë qeverisë lokale që të fokusohet në planin e punës përvitit 2023 të miratuar dhe të vazhdohet me qeverisje të mirë siç ka qenë edhe deri tanë. Sa përsqarim të z. Raci në lidhje me raportin voluminoz, edhe puna e ekzekutivit ka qenë voluminozë. Ndërsa përfaqësuesi i

LVV i cili thirret si grup por nuk janë grup kuvendar sepse grupi kuvendar përbehet nga tre e më shumë anëtarë, tha se është votuar ekzekutivi vitin e kaluar. Ja bëjë me dije që ekzekutivi nuk votohet por emërohet nga kryetari i Komunës.

z. Zafer Gashi: z. Bacaj mund të ketë qenë ndonjë lapsus, qëndron kjo e fundit. Ne këtu jemi grup kuvendar sepse na ka votuar populli. Ju jeni munduar që të na largoni nga Komiteti për financa por nuk keni pasur mundësi. Ne jemi dhe do të jemi grup kuvendar.

z. Esat Raci: E thash në fillim dhe qëndroj pranë asaj që thash në lidhje me raportin voluminoz. Dua të shtoj se puna nuk llogaritet me shumësinë por me kualitet. Sa përket premtiveve, ne kemi hyrë në garë zgjedhore me programe. As 50% e premtiveve për vitin e parë të qeverisjes nuk janë përbushur premtimet.

z. Valmir Bacaj: Përsëri dëshiroj të ja kujtoj z. Gashi se sipas ligjit për vetëqeverisje lokale grupei kuvendar përbehet nga dy e më shumë anëtarë. Përndryshe ne nuk shohim asnjë rrezik nga LVV sepse tendencia e kësaj partie është në rënien. Mandatin e kaluar i kanë pasur dy anëtarë edhe kësaj radhe i kanë dy. Nuk ka ngritje fare. Jemi komod.

z. Zafer Gashi: Ju jeni shumë të mirë zoti kryesues sepse lejoni që njerëzit të shprehin dëshirat këtu. Më të vërtete ne shpresojmë se qytetarët janë duke u vetëdijesuar dhe parë të vërteten. Ne shpresojmë gjithashtu në një bashkëpunim të mirë me z. Enver Berisha dhe Agron Bacaj nga Aleanca.

z. Tunë Dedaj: Përvendetje të gjithëve. Unë e kuptoj opositën për kritiken, ajo edhe është puna e saj por unë dua ta falënderoj shumë z. Zenun Elezaj për punën e bërë me gjithë vështirësitë që ka pasur. Uroj që të mos ndaloj dhe të vazhdoj edhe më tutje me punën e mirë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ky rapport duhet të vijë vetëm të shqyrtohet dhe të mos votohet hiç d.m.th. të mos i nënshtronhet votimit. Me më pyet mua unë kam më shumë vërejtje teknike tek ky rapport d.m.th. mënyrën qysh është shkruar, disa faqe janë landscape e disa portret. Ky rapport kur të votohet sot nuk mund të preket asnjë gjë. Do të duhej të ishte përgatit më mirë teknikisht.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Kemi mundësi shumë për të diskutuar rreth projekteve por unë po ndalem pak në disa të veçantë. Kur u përmend stacioni i autobusëve. Me buxhetin e vitit 2023 janë parapa mjete përfunduar e dytë. Faza e parë ka përfunduar vitin e kaluar. Tek ndriçimi, këtë vit fshati Çabiq do të përfshihet gjithsesi. I kemi kushtuar kujdes të veçantë kullës së heroit Mujë Krasniqi. Në lidhje me arsimin, drejtori ka pasur një problem shëndetësor dhe nuk është prezent por do të kemi mundësinë që të diskutojmë në seancat e radhës.

z. Zafer Gashi: Në projektet kapitale të vitit 2021 shkruan Stacioni i autobusëve ka përfunduar, këtu nuk shkruan as faza e parë as e dyta.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Unë e theksova se ajo ka qenë faza e parë dhe që ka përfunduar. Tani është paraparë buxhet për fazën e dytë. Njëjtë edhe tek baseni akumulues që është projekt tre vjeçar, ku faza e parë është evidentuar, pas kësaj nis faza tjetër e paraparë.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Përshëndetje. E sqaroi shumë mirë kryetari rreth stacionit të autobusëve. Unë e kam këtu në tabelar këtë fazë dhe shkruan faza e dytë, nuk e diji ku e ka marrë Zaferi atë material. Në raport shkruan se është në procedurë të kontraktimit faza e dytë dhe është projekt tre vjeçar. Në 2023 përfundon.

z. Zafer Gashi: Duhet të jemi serioz në dokumente. Ajo tabele e juaja është shkarravitje. Shiko ajo pjesë shumë pak shihet. Shikoj realizimet që janë në ueb të komunës, aty del që stacioni ia autobusëve është i përfunduar.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Unë nuk e kam detyrë që ta rregulloj tabelarin. Mund të ketë ndodhë që është deformuar gjatë punimit por e kam shumë të shkruar mirë dhe pastër ashtu siç është edhe ne ueb të komunës që shumë çartë lexohet faza e parë e dytë etj.

Raporti i punës së ekzekutivit për vitin 2022 u vendos në votim dhe me 16 vota për, 8 vota kundër dhe asnjë abstinenim U MIRATUA.

Pika e 5 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023

z. Enver Berisha, drejtor FEZH: Përshëndetje të gjithëve. Duke u bazuar mbi ligjin e buxhetit dhe ligjin e financave publike, ne si komune nga te hyrat që kanë mbetur kemi qenë të obliguar që ta bëjmë planifikimin e shpërndarjes së mjeteve. Vlera e kësaj shume është 1 milion e 322 mijë e 987 euro. Mjete që janë shpërndata nëpër programe të caktuara. Fillimisht jam i obliguar që të jua prezantoj një ndryshim i vogël që ka ndodhur dje. Ka të bëjë për shumën 183.50 cent nga mallra dhe shërbime. Si dhe vlera prej 2972 euro që janë hequr nga mallrat dhe shërbimet dhe kthehen në drejtorinë e shëndetësisë. Ndarjen e mjeteve të mbeturat ju veç e keni parë në materialin e marrë.

z. Zafer Gashi: Kjo lidhet pak a shumë me raportin që e debatuam. Ne e kemi pasur gati të njëtin edhe vitin e kaluar. Ne si LVV mendojmë se ka bartje në vendet që ndoshta mund të pritet ose kemi raste- fshatra që edhe herën e kaluar kemi bërë bartje të mjeteve si për shembull në Zajm dhe tani prap aty po i bartim. Ndoshta ndërtimi i linjës për ndriçim publik në Sferkë ndoshta është i llogaritur gabim, janë planifikuar bartje e vogël e mjeteve. Mendoj që kjo bartje duhet të rishikohet dhe të jetë funksionale për vendet ku duhet si p.sh. planifikimi për rregullimin e varrezave të dëshmorëve ose kompensimin e familjeve të dëmtuara nga vërshimet.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Bartja e mjeteve të mbeturat bëhet për projektet që janë në vazhdimësi e nuk mund të hapen kode të reja. Pra duhet të jenë projekte nga viti 2022. Kemi obligime nga viti i kaluar p.sh. Liqeni akumulues, jemi të obliguar që të bartim mjetet për të vazhduar projektin sepse vitin e kaluar është punuar shumë pak në këtë

projekt. Prandaj bëhet bartja që të realizohet projekti me efikasitet. Me gjithë këtë ne bashkërisht do të shohim aty ku është e nevojshme dhe gjatë rishikimit të buxhetit do të bëjmë bartje të mjeteve në projekte të nevojshme. Sa i përket dëmeve të krijuara nga vërshimet, ne e kemi dorëzuar raportin në qeveri dhe shpresoj që shumë shpejt do të na dalin në ndihmë.

Me 25 vota për, asnë kundër , 2 abstenime(LVV) U MIRATUA.

Pika 6 e Rendit ét Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të drejtorisë së Urbanizmit për ridestinim të parcelës nr. 00109-0 zona kadastrale Dollc për ndërtimin e shtëpisë së të moshuarve.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit: Drejtoria e Urbanizmit me kërkesë të drejtorisë së Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, me kërkesën nr. 00109-0 ZK Dollc i drejtohet kuvendit që të bëhet ridestinimi i parcelës së përzgjedhur për ndërtimin e shtëpisë së të moshuarve. Ne si drejtori jemi të obliguar që të bazohemi në Hartat Zonale kur bëjmë përcaktimin e lokacionit. Parcela që është destinuar për këtë qellim është parcelë private, gjendet afér lumit "Drini i Bardhë" dhe kërkohen procedura shpronësimi e po ashtu është zonë që mund të rrezikohet nga vërshimet. Në këtë rast bije në kundërshtim me kriteret bazuar në Hartat Zonale. Tani parcelën që ne e kemi përzgjedhur është zonë banuese. Kjo parcelë është në pronësi të shkollës filllore në Dollc prandaj kemi kërkuar nga Kuvendi sot që të bëhet ridestinimi i kësaj parcele.

z. Esat Raci: Deshiroj që të kemi një orientim me të shkoqitur. Jo me numër të zonës. Ku gjendet saktësisht kjo parcelë?

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit: Saktësisht është parcelë e ngjitur me shkollën e Dollcit. Nuk është Parcelë e destinuar për shkollë edhe pse është pronë e shkollës. Është e banueshme dhe përafërsisht i ka 30 ari.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Rruga që po ndërtohet tani është planifikuar që të kaloj andej dhe aty do të bëhet një rrëth rrrotullim . Kjo parcelë do at ketë në afërsi 100 metra këtë transit. Ajo është pronë shoqërore- komunale dhe neve na duhet një vendim i kuvendit në këtë rast.

z. Zafer Gashi: Ne si LVV e përkrahim dhe është shumë e qëlluar, ju përgëzojmë.

z. Valmir Bacaj: Duke parë rëndësinë e madhe që ka Kлина për ndërtimin e shtëpisë së të moshuarve , ne si grup kuvendar e përkrahim.

Me 26 vota për,asnë kundër dhe asnë abstenim U MIRATUA.

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit nga drejtoria e urbanizimit për lëshurje në diskutim publik të draft rregullores komunale për bonuset e zonimit.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit: Ju informoj se kjo rregullore është në përputhje me dokumentet strategjike komunale. Përmes kësaj i mundësohet komunës

fushëveprimi dhe menaxhimi i parcelave që janë të përcaktuara për zhvillim si ndërtim dhe infrastrukturë rrugore. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, hartat zonale të Komunës do të janë më të zbatueshme dhe do të ndihmojnë zhvillimit. Kjo rregullore ka paraparë shkurtim të procedurave të shpronësimit të parcelave që janë private dhe që sipas hartave zonale ato parcella janë paraparë për ndërtim të infrastrukturës rrugore etj. Për përbajtjen e gjerë të kësaj rregullore e keni të shkruar në materialet që drejtoria juva ka dërguar me kohë. Ju ftoj që ta votoni pro këtë fazë fillestare.

Me 26 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 8 e Rendit ét Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të zyrës për komunitete dhe kthim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për komunitete.

Kryesuesi sqaroi se kërkesa ka ardhur nga zyra për komunitete dhe kthim për zëvendësimin e një anëtareje të komitetit për komunitete me një anëtare tjetër të propozuar. Kryesuesi theksoi se nuk mendon se kemi të drejt që ta shqyrtojmë dhe vendosim për këtë anëtare të propozuar pasi që anëtarja e propozuar nga kjo zyre nuk e ka shtetësinë e Kosovës por ka vetëm leje qëndrim. Shërbimi është konsultuar edhe me zyrën ligjore dhe gjitha organet e tjera relevante prandaj nuk mund të vendosim si kuvenç që të votojmë një anëtare për komitetin për komunitete që nuk është shtetase e Kosovës.

z. Zafer Gashi: Dua të pyes nëse është ligjore që kërkesa të bëhet vetëm në gjuhen serbe si në këtë rast?

z. Fadil Gashi, kryesues: Ligji e njeh gjuhë zyrtare edhe gjuhen serbe edhe pse administrata është dashur që të jua përkthej në gjuhen shqipe anëtarëve të Kuvendit.

Kryesuesi e vendos në votim refuzimin e kësaj kërkesë dhe me 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA refuzimi i kërkesës në fjalë.

Pika 9 e Rendit ét Ditës: Pyetje dhe Përgjigje.

z. Tunë Dedaj: Kam dy kërkesa për dy drejtorë. Trotuari që është duke u ndërtuar shumë i bukur deri tek udhëkryqi të largohen nga trotuari shtyllat e rrymës. Dhe për drejtorin e bujqësisë, nëse ka paraparë ndarjen e serave të parashikohet me kohë kjo ndarje dhe jo të shkoj vera e të mos ndahan.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit: Po është shqetësim me vend. Në para masë është paraparë që OE të bëjë dislokimin e tyre. Kemi biseduar me operatorin dhe ka premtuar që në mundësinë e parë do ta bëjë.

z. Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë: Tunë nuk keni qenë të informuar por ajo procedurë ka filluar që para një muaj e gjysmë, sot pritet të nënshkruhet kontrata me operatorin.

Znj. Arta Pantina: I nderuar kryetar, ekzekutiv. Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Unë si anëtare e komitetit për shërbime publike kemi pasur teme

diskutimi ndriçimin publik nëpër fshatra. Në fshatin Rixhevë një pjesë nuk është mbuluar me ndriçim si dhe në Gllarevë shumë herë ka probleme me këtë. Pse nuk është kompletuar fshati Rixhevë me ndriçim publik nëse mund të na tregoni dhe nga çka vijnë problemet me ndriçim publik në Gllarevë?

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHP: Sa më kujtohet për ndriçimin në Rixhevë e kam pasur një kërkesë për rregullim, është rregulluar. Në Gllarevë sikurse edhe në qytet edhe në fshatrat e tjera kemi dëmtime edhe të qëllimshme. Këto raste i kam lajmëruar në polici. Po ashtu probleme po krijojnë edhe punimet e KEDS të cilët pasi të bëjnë punimet po vonohen deri të na informojnë.

z. Valmir Bacaj: Unë më shumë kam një sqarim për qytetarët e Klinës pasi që ditëve të fundit kemi marrë një paralajmërim nga LVV për një seancë të jashtëzakonshme për faljen e tatimit në pronë, në shumë prej 100 eurove. Për informim, kjo seancë e paralajmëruar nuk është mbajtur. Ndoshta do të duhej që qytetarët e Komunës të kenë shpjegime se pse nuk është mbajtur kjo seancë. Ne si grup kuvendar e kemi pasur të qartë sepse ligji për tatimin në pronë është votuar në Kuvend dhe vetëm Kuvendi i Republikës mund ta ndryshoj atë ligj. Qëndrimi ynë është që të kthehet vlera e koeficienteve të vlerësimit të pronave qysh ka qenë sepse as falja prej 100 euro nuk është zgjidhje e problemit afatgjatë. Përndryshe ne si grup çdo kërkesë që është në të mirë të qytetarëve do ta përkrahim dhe nënshkruajmë.

z. Zafer Gashi: Inderuar Valmir po na befason për të mirë kjo gatishmëri e jotja në iniciativat tonë. Nuk e kemi thirru këtë seancë është e vërtetë, ka qenë koha e vërvshimeve dhe kemi menduar që ta shtyjmë për një kohë tjeter. Pyetja ime është për drejtorin e shëndetësisë: Ju keni deklaruar në proces se do ta sjellni këtë muaj statutin e QKMF-së. Nuk e keni sjellë akoma. (Ndërhynë drejtori z. Agron Bacaj duke thënë se është thënë që do at sjellim në muajin mars, akoma nuk jemi në muajin mars). Pasi që nuk është këtu drejtori i arsimit dua ta pyes kryetarin në lidhje me zgjedhjen e drejtorëve të shkollave. A mendoni edhe ju që ka shkuar gjithçka në rregull? Si është e mundur që një kandidatë të del i pari me pikë në Sferkë dhe i treti në Grabanicë? A lënë kjo për të dyshuar sepse nëse ai i ka ditur pyetjet për Sferkë është dashur që të i dijë edhe për Grabanicë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Besoj që kjo është në kompetencë të komisionit. Ndoshta është më mirë të pyetet komisioni. Komisioni është i përbërë nga dy anëtarë që i kemi votuar ne dhe një anëtar nga ministria. Nuk jam që mund të përgjigjem saktë tani por mendoj që fokusimi i kandidatit dhe arritja e suksesit në vlerësim ka qenë i orientuar aty ku ka pasur synimin për tu zgjedhur. Mendoj që duhet të i besojmë komisionit në përzgjedhjen e tyre.

z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë: Draft statuti i QKMF-së është i rregulluar në bazë të udhëzimit administrativ në nivel të vendit. Tek kriteret nuk mund të ndryshojmë asgjë sepse do të na kthejnë ministria e shëndetësisë në pikën zero. Ne pasi që ta përfundojmë me ministrinë e shëndetësisë do ta sjellim në Kuvend këtu. E kemi bërë

draftin gati dhe jemi në bisedime me ministrinë e shëndetësisë por kriteret nuk mund të i ndryshojmë as ajo për të cilën aludon Zaferi, tek zgjedhja e drejtorit të QKMF-së.

Znj. Valmira Krasniqi: Dua të bëjë dy pyetje kryetarit. Një vendim para dy viteve është marrë këtu për sektorin privat për pushim gjatë vikendeve. Pse nuk po zbatohet ky vendim. Pyetja tjetër është ligji kundër përdorimit të duhanit në hapësirat e brendshme. Pse s' po zbatohet ky ligj?

z. Zenun Elezaj, kryetar: Për pyetjen e parë. Ne, rregulloren e kemi në aprovim e sipër që nga mandati i kaluar. Një herë ka qenë kërkesë e vet bizneseve që kanë kërkuar mundësimin për të pushuar. Të njëjtat biznese kanë ardhur më mbrapa dhe kanë kërkuar që të punohet pasi që vet punëtorët e tyre po shkojnë në Pejë gjatë vikendeve për tu furnizuar dhe të mos implementohet vendimi që kemi marrë. Rregullorja ende nuk është finalizuar prandaj do të duhet të merret bashkërisht një vendim. Ligji kundër duhanit është në fuqi dhe do të duhet që të ndalohet përdorimi i tij në hapësirat e ndaluara. Do ët angazhohemi gjithsesi që ky ligj të zbatohet në përpikëri.

Znj. Blerina Gashi: Dua të pyes drejtorin e Urbanizmit se deri ku ka shkuar realizimi i projektit për sheshin "Ibrahim Rugova"?

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit: Projekti është dy vjeçar, është i kontraktuar dhe jemi duke përzgjedhur një projekt të përshtatshëm për tu realizuar. Shumë shpejt do të kryhet.

z. Ndrec Zefaj: Kam një pyetje për kryetarin e Komunës për një projekt në fshatin Zllakuqan për projektin "Ranovica" rritjen e lartësisë së këtij kanali. A do të vazhdohet me anësorët e betonit deri në fund të këtij kanali dhe kur parashihet që të përfundoj?

z. Zenun Elezaj, kryetar: Projekti është duke u implementuar që nga viti i kaluar. Gjatë dhe pas vërvshimeve i kam takuar banorët dhe është parë e nevojshme që të vazhdohet edhe një fazë tjetër sepse thënë të drejtën ka dalë domosdoshmëri që të ngriten anësorët e kanalit dhe është duke u bërë në afërsi të Kishës. Do të shohim këtë vit me buxhetin e ndarë për këto fshatra këtë vit ta përfundojmë. Këtë vit nuk kemi mundësi që ta përfundojmë në tërësi ngritjen e anësorëve të kanalit me beton por aty ku mbetemi do ta rregullojmë me argjila.

z. Armend Beqiri: Përrshëndetje. Kam një pyetje për drejtorin e urbanizmit. Në Grabanicë në lagjen "Sejdiu" është bërë vendosja e gypave. Projekt tepër i mirë që në rast të vërvshimeve ndihmojnë në shkarkimin e ujit. Gjatë vendosjes së Gypave është dëmtuar asfalti në të dy anët. Përgjegjësi e kujt është që të rregullohet asfalti?

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizmit: Kemi një projekt për Grabanicë, Dollovë, Bokshiq dhe ka mundësi që në para masa ta fusim edhe atë rregullim të rrugës.

Kryesuesi në fund theksoi se është një rregullore në diskutim publik për përdorimin e duhanit, zhurmës, respektimin e orarit të punës së bizneseve dhe kërkoi që secili të jap kontributin e tij me ide. Kontributi më i mirë do të ishte që gjithsecili, edhe zyrtarët

publik, edhe policia edhe organet e tjera ta respekojnë vet këtë rregullore fillimisht. Po ashtu kryesuesi kërkoj që të themelohet grapi i grave kuvendare dhe të filloj të funksionoj. Krejt në fund, kryesuesi z. Gashi duke i falënderuar ét gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë shpalli të mbyllur punimet e kësaj seance.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

